



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 769/2 Prot.

Tiranë, më 09.11.2021

V E N D I M

Nr.140, datë 09.11.2021

Mbi përfundimin e hetimit administrativ, me objekt verifikimin e ligjshmërisë së procesit të vlerësimit periodik Janar – 15 Korrik 2021, të nëpunësit *** , me detyrë “Specialist për Terrenin në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore” në Bashkinë Kamëz.**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar; nenit 90/1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me disa pretendime për parregullsi në zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, në procesin e vlerësimit të rezultateve në punë, për periudhën e vlerësimit Janar -15 Korrik 2021, të paraqitur nga nëpunësi ***** , me detyrë “Specialist për Terrenin në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore”, pranë institucionit e Bashkisë Kamëz,

Vërej se:

Nëpunësi civil ***** , nëpërmjet një kërkesë të regjistruar me nr. 769 prot., datë 25.08.2021, ka ngritur disa pretendime për parregullsi të kryera ose të lejuara në procesin e vlerësimit të rezultateve në punë, për periudhën e vlerësimit Janar -15 Korrik 2021.

Për efekt të kryerjes së hetimit administrativ, bazuar në nenin 16, Kreu III “Procedura paraprake”, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me

vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, u shqyrtua materiali shkresor që shoqëronte kërkesën e nëpunësit, si dhe dokumentacioni i përcjellë nga institucioni Bashkia Kamëz, në datën 15.09.2021, “*Dërgim dokumentacioni ******” (në përgjigje të kërkesës për dokumentacion dërguar nga Komisioneri me E-mailin e datës 08.09.2021).

Në përfundim të shqyrtimit të materialeve të mësipërme, rezulton se nëpunësi në fjalë ka filluar punë në Bashkinë Kamëz, me urdhrin nr 190, datë 31.05.2013, të Kryetarit të Bashkisë dhe fillimi i efekteve të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, e ka gjetur të punësuar në pozicionin “*Përgjegjës pranë Sektorit të ndihmës ekonomike*”.

Bazuar në pikën 4, të nenit 67, të ligjit në fjalë, ai është konsideruar nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin “*Përgjegjës pranë Sektorit të ndihmës ekonomike*”. Më pas, me aktin e emërimit nr. 213 prot., datë 01.09.2015, të Kryetarit të Bashkisë Kamëz (pa respektuar ndonjë procedurë ligjore, por që është pranuar nga paditësi dhe tashmë është bërë fakt i kryer), ka kaluar në pozicionin “*Specialist për Terrenin në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore*”, në këtë bashki, pozicion në të cilin ka vazhduar të punonjë pa ndërprerje, të cilin e mban edhe aktualisht.

Fakti si më sipër, është konstatuar dhe analizuar edhe në vendimin nr. 13, datë 29.01.2016 “*Për miratimin e raportit përfundimtar të administrimit të shërbimit civil në Bashkinë Kamëz*”, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ku rezulton se njësisë përgjegjëse të Bashkisë Kamëz i është lënë detyrë, marrja e masave të nevojshme për zbatimin e detyrimeve ligjore të parashikuara në nenin 24, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, në lidhje me punonjësit në periudhë prove, duke përfshirë përfundimin e trajnimit në Shkollën e Administratës Publike (ASPА); përcaktimin e një punonjësi më të vjetër për t’u kujdesur, si dhe vlerësimin e punës nga eprori dhe pas kësaj detyrimit për tu shprehur për konfirmimin ose jo të nëpunësve civilë në periudhë prove, ku përfshihet dhe rasti i ankuesit *****.

Në zbatim të detyrimit të mësipërm, ankuesi ka kryer me sukses trajnimin pranë ASPA, por megjithatë, pavarësisht se ka kaluar një kohë e gjatë (afro 7 vjet) procesi nuk është përmbyllur me aktin e eprorit direkt për vlerësimin në fund të periudhës së provës dhe njësia përgjegjëse nuk ka nxjerrë aktin e konfirmimit të statusit të punësimit, si nëpunës civil. Megjithatë, kjo moskryerje e detyrës nga ana e administratës së institucionit, nuk mund dhe nuk duhet të penalizojë nëpunësin, prandaj bazuar në parimet dhe frymën e legjislacionit të shërbimit civil, arrihet në përfundimin se nëpunësi *****, duhet të konsiderohet nëpunës civil i konfirmuar dhe gëzon të drejtat dhe detyrimet e shpallura e të mbrojtura prej këtij legjislacioni.

Pas zgjidhjes së problemit të ekzistencës ose jo të statusit të nëpunësit civil, i cili determinon kompetencën për shqyrtimin e rastit nga ana e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, u kalua në analizimin e pretendimeve të ngritura prej nëpunësit në fjalë, për vlerësimin negativ për periudhën Janar-Qershor 2021.

Nga këqyrja e dokumentacionit të administruar, konstatohet se formulari i vlerësimit të rezultateve në punë, nuk është i rregullt nga pikëpamja formale pasi nuk është nënshkruar nga të gjithë personat përgjegjës, të ngarkuar nga ligji për kryerjen e procedurës së vlerësimit (*zyrtari raportues, zyrtari kundërfirmues dhe zyrtari autorizues*) por është nënshkruar vetëm nga drejtori i Drejtorisë së Tatim Taksave (*i cili në këtë rast paraqitet si Zyrtar Kundërfirmues*), nga Kryetari i Bashkisë (*në cilësinë e Zyrtarit Autorizues*) dhe nga drejtuesi i njësisë së burimeve njerëzore.

Referuar Vendimit me Nr. 109, datë 26.2.2014 të Këshillit të Ministrave “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë*”, i ndryshuar, në pikën 3, të kreut II të tij, “*Sistemi i Vlerësimit të Rezultateve në punë*”, përcaktohet qartë se: “*Vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësin civil të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese kryhet bashkërisht nga zyrtari raportues, zyrtari kundërfirmues dhe zyrtari autorizues*”, duke respektuar fazën e planifikimit, fazën e bisedimeve të ndërmjetme dhe fazën e vlerësimit përfundimtar.

Në kuptim të kreut I, pikës 2, të këtij vendimi:

- b) “*Zyrtar raportues*”, është nëpunësi që mbikëqyr në mënyrë të drejtpërdrejtë në linjën e hierarkisë organizative, nëpunësin që do të vlerësohet;
- c) “*Zyrtar kundërfirmues*”, është nëpunësi që mbikëqyr në mënyrë të drejtpërdrejtë në linjën hierarkike, zyrtarin raportues;
- ç) “*Zyrtar autorizues*”, është nëpunësi që mbikëqyr në mënyrë të drejtpërdrejtë në linjën e hierarkisë, zyrtarin kundërfirmues.

Nisur nga përkufizimet e mësipërme, në përputhje me kushtet konkrete të bashkisë, akti i vlerësimit duhej të ishte plotësuar dhe nënshkruar nga “*Zyrtar raportues*”- Përgjegjësi i Sektorit, “*Zyrtar kundërfirmues*”, - Drejtori i Drejtorisë dhe si “*Zyrtar Autorizues*”- duhej të paraqitej Drejtori i Përgjithshëm i linjës, i cili meqënëse sipas pohimit të njësisë përgjegjëse është pozicion vakant, autoriteti i tij i kalon Kryetarit të Bashkisë Kamëz.

Duke ju referuar pikës 4 të Kreut III të vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për vlerësimin e rezultateve në punë për nëpunësit civil*”, i ndryshuar, zyrtari autorizues merr vendimin përfundimtar për vlerësimin e rezultateve në punë, në mënyrë të arsyetuar, sipas përcaktimit të bërë në nenet 99 e 100, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*”. Ky vendim në çdo rast duhet të jetë i qartë dhe i argumentuar, për të evituar subjektivizmin dhe keqkuptimet që mund të lindin, qoftë

ndërmjet zyrtarëve pjesëmarrës në proces, ashtu edhe me nëpunësin. Nga materialet e dokumentuara rezultojnë që edhe kjo kërkesë ligjore nuk është respektuar, pasi edhe konkluzionet e zyrtarëve përkatës janë të paarsyetuara dhe të paargumentuara. Mungesa e komenteve në të gjitha rubrikat, do të thotë se jemi përpara një procesi administrativ me mangësi në raport me kërkesat ligjore, i cili shoqërohet me konkluzione me karakter subjektiv dhe të pa verifikueshme, si nga ana e zyrtarëve që marrin pjesë në proces, pasi nuk kanë mundësi të vlerësojnë konkluzionet e zyrtarit paraardhës, ashtu edhe nga ana e organeve mbikëqyrëse.

Njëkohësisht, rezultojnë se ndaj vlerësimit 4 “*Jo kënaqshëm*”, punonjësi ***** nuk ka qenë dakort dhe ka kërkuar rivlerësim të rezultateve të punës, fakt që gjen pasqyrim në kërkesën për rivlerësim, e dorëzuar në datën 21.07.2021 “*Ankimim*” drejtuar Kryetarit të Bashkisë, në cilësinë e zyrtarit autorizues (*për shkak se, siç u përmend edhe më lart, pozicioni i Drejtorit të Përgjithshëm i Zhvillimit Ekonomik, nga e cila varet drejtoria përkatëse sipas strukturës të miratuar me vendimin nr 37 datë 14.01.2021 “Për miratimin e Strukturës Organizative të Bashkisë Kamëz”, është pozicion vakant*).

Ndaj ankimit të ushtruar rezultojnë se nuk ka rivlerësim dhe as përgjigje drejtuar punonjësit, për këtë arsye në datën 01.09.2021, punonjësi ka përsëritur kërkesën për sqarimin e situatës, por që përsëri nuk ka marrë asnjë përgjigje, gjë e cila shërben si shkak për tërheqje vëmendje ndaj njësisë përgjegjëse të bashkisë, e cila ka detyra të posaçme në drejtim të sigurimit të kushteve optimale ligjore, për mbrojtjen e të drejtave të nëpunësve civilë.

Nga sa parashtruam më sipër dhe nga analiza në tërësi e dokumentacionit dhe e rrethanave të çështjes, arrijmë në konkluzionin se procedura e ndjekur për vlerësimin e rezultateve në punë për punonjësin ***** është kryer në kundërshtim me nenin 62, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar dhe të vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil*”, i ndryshuar me vendimin nr. 252, datë 30.03.2016, të Këshillit të Ministrave.

Nisur nga gjithë sa më sipër, arrihet në përfundimin se procesi i vlerësimit të nëpunësit ***** për periudhën Janar - Korrik 2021, është një proces që përmban elementë të kundraligjshëm, prandaj në bazë të nenit 109, pikat “*d*” dhe “*dh*” dhe 113/1, të ligjit nr.44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*”, vetë organi publik (*Zyrtari Autorizues – në këtë rast Kryetari i Bashkisë*) duhet të vendosë anulimin e procesit të vlerësimit dhe të urdhërojë përsëritjen e tij nga fillimi, duke patur për bazë rregullat për të cilat u fol në pjesën e mësipërme të këtij relacioni.

Për këto arsye:

Në zbatim të nenit 15 pika 1, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, neneve 54 e 55, pikave “d” dhe “dh” të nenit 109 dhe nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH” dhe neneve 16, pika 8 dhe 35, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë:

VENDOSA:

1. Të kërkoj nga Kryetari i Bashkisë Kamëz, në cilësinë e Zyrtarit Autorizues, të vendosë anulimin e procesit dhe aktit të vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësit ***** , për periudhën Janar – Qershor 2021, si një proces i kundraligjshëm dhe përsëritjen e procesit.
2. Njësia përgjegjëse duhet të kërkojë nga eprori direkt (Zyrtarët Raportues e Kundërfirmues të këtij nëpunësi), përsëritjen e procesit të vlerësimit, duke mbajtur parasysh respektimin e fazave të procesit dhe vërejtjet e përmendura në pjesën arsyetuese të vendimit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi, lihet një afat 20 ditë nga komunikimi i vendimit.
4. Ky vendim ti komunikohet, Bashkisë Kamëz dhe nëpunësit *****.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha